



PROCEDURE PER EKZEKUTIMIN ME TE MIRE

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SH.A

	<i>Titulli/ Njësia</i>	<i>Firma</i>
Përgatitur nga:	Këshilltari i CEO për Investimet	
Rishikuar nga:	Divizioni i Operacioneve, Kujdestarisë dhe Depozitarit	
	Divizioni i Menaxhimit të Riskut dhe Kontrollit të Vazhdueshëm	
	Divizioni i Financës	
	Departamenti i Thesarit	
	Divizioni Ligjor dhe i Përputhshmërisë	
Statusi dhe versioni:	Aprovuar, V.1	
Kodi i Procedurës		
Data e fundit e modifikimit:	06.01.2022	
Në fuqi që prej:		

Neni 1

Qëllimi i kësaj Procedure

- 1.1 Procedura e ekzekutimit më të mirë (Procedura) Përcakton informacionin në lidhje me mënyrën se si Banka Amerikane e Investimeve (“ Banka ”) realizon ekzekutimin më të mirë siç kërkohet nga Ligji 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” në rastet kur ekzekuton urdhra në emër të klientëve.
- 1.2 “ Ekzekutimi më i mirë ” është termi i përdorur për të treguar detyrën që ka Banka që të ndërmarrë të gjithë hapat e mjaftueshëm për të arritur rezultatet më të mira të mundshme kur Banka merr ose transmeton ëurdhëra ose ekzekuton urdhëra në emër dhe për llogari të klientëve duke marrë në konsideratë rrethanat përkatëse.

Neni 2

Fusha e zbatimit

- 2.1 Kjo procedurë zbatohet në rastet kur Banka merr dhe transmeton urdhëra për emër dhe llogari të klientëve, në rastet kur Banka ekzekuton urdhëra në emër dhe llogari të klientëve si edhe në rastet kur vepron si administrator portofoli në emër të klientëve, për instrumentet financiare si në vijim:
 - a) Aksionet, duke përfshirë dëftesat e depozitarit;
 - b) Titujt e Borxhit;
 - c) Kuotat ose aksionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive;
- 2.2 Kjo Procedurë nuk zbatohet në rastet kur:
 - a) Banka vepron në emër dhe për llogari të klientëve të klasifikuar si Palë të Pranueshme në kuptim të ligjit 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”
 - b) Kur vepron pas një udhëzimi specifik/urdhëri specifik të dhënë nga klienti i cili e pengon Bankën për të siguruar Ekzekutimin më të Mirë.

Neni 3

Faktorët e Ekzekutimit

- 3.1 Në përpjekje për të arritur ekzekutimin më të mirë në lidhje me një urdhër të veçantë, Banka do të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës duke përfshirë sa vijon:
 - a) çmimi : ky është çmimi me të cilin tregtohet një instrument financiar;
 - b) kostot: kjo përfshin të gjitha tarifat dhe kostot që lidhen me ekzekutimin e urdhërit
 - c) shpejtësia: kjo është koha që duhet për të ekzekutuar një transaksion;

- d) Probabiliteti i ekzekutimit dhe shlyerjes: ka të bëjë me probabilitetin e realizimit të transaksionit dhe të shlyerjes
- e) madhësia: kjo ka të bëjë me shumën e urdhërit
- f) natyra e transaksionit ose ndonjë konsideratë tjetër në lidhje me ekzekutimin e transaksionit: kjo është mënyra se si karakteristikat e veçanta të një transaksioni mund të ndikojnë në ekzekutimin më të mirë.

3.2 Banka do të përcaktojë rëndësinë relative të secilit prej faktorëve të ekzekutimit duke përdorur gjykimin dhe përvojën që ka në tregtimin e instrumentave financiare, duke u bazuar në informacionin e disponueshëm të tregut dhe duke marrë parasysh një numër kriteresh, si në vijim:

- a) Qëllimi i investimit i klientit i cili ka vendosur urdhërin;
- b) Karakteristikat e instrumenteve financiare që i nënshtrohen këtij urdhri, p.sh. aksione ose tituj borxhit;
- c) Llojet e vendeve të tregtimit ku mund të vendoset urdhëri
- d) Karakteristikat dhe natyra e urdhërit, përfshirë nëse janë dhënë udhëzime specifike;
- e) Kategorizimi i klientëve të Bankës të tilla si klient profesionist apo i kualifikuar, ose klient jo profesionist.
- f) Kushtet e tregut, të tilla si shkalla e likuiditetit dhe luhatshmërisë në treg.

3.3 Për shumicën e transaksioneve, faktorët kryesorë të ekzekutimit mbi të cilët do të vendoset përparësia e ekzekutimit të urdhërit do të jenë si më poshtë:

- a) Mundësia e ekzekutimit / madhësisë - duke pasur parasysh madhësinë e tregtimit në tregje të ndryshme, Banka mund ti japë përparësi probabilitetit për të ekzekutuar urdhërin në atë madhësi që kërkohet nga klienti, që do të thotë se mund të favorizojë vendet e ekzekutimit të cilat do të lejojnë plotësimin e madhësisë së urdhërit, ose të paktën një pjesë materiale të tij. Këtu mund të jetë vecanërisht rasti kur një urdhër është i madh, ose kur një instrument i veçantë nuk është shumë likuid;
- b) Çmimi - kjo nënkupton çmimin e instrumentit (dmth. duke mos përfshirë kostot e aplikuar nga ndërmjetësi ose vendi i ekzekutimit); dhe
- c) Shpejtësia – Duke konsideruar lëvizjet e shpejta të cmimeve të instrumentave financiare, shpejtësia mund të jetë një faktor thelbësor. Nëse Klienti beson që tregu të mund të lëvizë shpejt në një periudhë afatshkurtër, ai / ajo mund të udhëzojë Bankën të konsiderojë shpejtësinë me prioritet në krahasim me faktorët e tjerë.

3.4 Në rastet e tregtimit në tregje në zhvillim, ku praktikat e tregut mund të jenë më pak të zhvilluara, Banka do të konsiderojë edhe kostot e transaksionit si faktor ekzekutimi.

3.5 Në shumicën e tregjeve të zhvilluara mundësia e klerimit dhe shlyerjes dhe realizimit të ekzekutimit është standarte dhe realizohet sipas parimit të shlyerjes kundrejt pagesës. Megjithatë në tregje më pak të zhvilluara theksi mund të vendoset në mundësinë e klerimit dhe shlyerjes së

titullit pasi mund të mos kenë krijuar ende të gjithë infrastrukturën e duhur për të realizuar një transaksion sipas parimit DVP.

3.6 Në rastet e Titujve të Qeverisë Shqiptare, Banka do të përzgjedhë opsionin më të mirë duke konsideruar faktorët e ekzekutimit, duke përfshirë mundësinë që ka Banka ta realizojë transaksionin së brendshmi duke tregtuar dhe nga portofoli i saj dhe do të kryhet si në vijim:

- a) Nëse klienti vendos një urdhër specifik në lidhje shitje ose blerje të titujve të qeverisë nuk zbatohet procedura e ekzekutimit më të mirë, dhe në këtë rast Banka vepron duke blerë ose shitur titujt nga portofoli i saj.
- b) Nëse pas vendosjes së urdhërit për blerje nga Klienti, nuk ka informacion mbi cmimin e titullit në treg, për atë madhësi dhe në kohën kur vendoset urdhëri, dhe Banka e zotëron titullin në portofolin e saj dhe ka interes ta tregtojë atë, Banka mund ti ofrojë Klientit titullin nga portofoli i saj, duke i dhënë klientit informacion në lidhje me yield-et e ankandëve të fundit të Bonove të Thesarit të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Në këtë rast Banka konsiderohet se ka zbatuar parimin e ekzekutimit më të mirë pasi i ka dhënë prioritet shpejtësisë dhe probabilitetit të ekzekutimit dhe shlyerjes të urdhërit.
- c) Nëse pas vendosjes së urdhërit për shitje nga Klienti, nuk ka informacion mbi cmimin e titullit në treg, për atë madhësi dhe në kohën kur vendoset urdhëri, dhe Banka ka interes ta blejë titullin për portofolin e saj, Banka mund ti ofrojë Klientit kuotim për blerje nga portofoli i saj, duke i dhënë klientit informacion në lidhje me yield-et e ankadëve të fundit të Bonove të Thesarit të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Në këtë rast Banka konsiderohet se ka zbatuar parimin e ekzekutimit më të mirë pasi i ka dhënë prioritet shpejtësisë dhe probabilitetit të ekzekutimit dhe shlyerjes së urdhërit.
- d) Nëse pas vendosjes së urdhërit për blerje ose shitje nga Klienti, nuk ka informacion mbi cmimin e titullit në treg, për atë madhësi dhe në kohën kur vendoset urdhëri, dhe Banka nuk ka interes të veprojë nga portofoli i vet me klientin, Banka rezervon të drejtën për të refuzuar transaksionin për shkak të mungesës së informacionit dhe mundësisë për ta ekzekutuar transaksionin në treg.
- e) Nëse pas vendosjes së urdhërit për blerje ose shitje nga Klienti ka informacion dhe mundësi për ta ekzekutuar transaksionin në treg, Banka vendos ta ekzekutojë urdhërin në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - i) Ta ekzekutojë urdhërin në Bursën ALSE, duke konsideruar ëmadhësinë e ëurdhërit dhe ëmundësinë e vendosjes së tij ënë ëBursë për atë madhësi, duke e lënë vlefshmërinë e urdhërit sipas kohës që përcaktohet nga klienti, ose sipas gjykimit të bankës nëse nuk është e specifikuar nga klienti.
 - ii) Ta ekzekutojë urdhërin duke tregtuar nga portofoli i vet, duke i dhënë prioritet shpejtësisë së ekzekutimit, nëse urdhëri nuk është i madhësisë së mjaftueshme për tu vendosur për ekzekutim në tregun e rregulluar.

e) Për qëllime të kësaj pike Banka merr informacion në lidhje me karakteristikat e tregut nëpërmjet:

- i) Informacionit që del nga kuotimet në Bursën ALSE në atë moment kur vendoset urdhëri nga klienti (shuma, cmimi etj)
- ii) Informacioni i mësipërm nuk do të konsiderohet nëse cmimi i fundit i përditësuar i tregut nuk është brenda kuadrit kohor të 30 minutave, nga momenti që është vendosur urdhëri nga klienti.

3.7 Zbatimi i faktorëve të ekzekutimit do të ndryshojë në varësi të tregtimit në tregje të caktuara, për shembull tregjet ku informacioni para tregtimit (pre-trade) është jashtëzakonisht i kufizuar dhe tregjet ku informacioni (pre-trade) është gjerësisht i disponueshëm dhe shumë transparent, ose për instrumente jolikuide në krahasim me për tregtimin e instrumenteve ku ka një nivel të lartë të likuiditetit.

3.8 Gjatë procesit të tregtimit, Banka do të përdorë ekspertizen dhe përvojën e saj për të arritur rezultatin më të mirë në të gjithë gamën e plotë të faktorëve; përfshirë këtu ku mund të bien ndesh me njëri-tjetrin.

Në përgjithësi, kjo mund të nënkuptojë që Banka mund të mos arrijë gjithmonë ekzekutimin më të mirë (duke marrë parasysh karakteristikat e çdo urdhëri) për çdo transaksion, pavarësisht përpjekjeve për të kërkuar ekzekutimin më të mirë.

Neni 4.

Bashkimi i Urdhërave

4.1 Banka mund të bashkojë urdhërat e Klientëve vetëm nëse ato janë të lidhura me të njëjtin instrument financiar dhe urdhëra të cilat nuk ndryshojnë në lloj dhe natyrë.

4.2 Banka mund të bashkojë urdhërat e Klientëve të cilat ndryshojnë nga “sasia e ekzekutimit” për shembull urdhërat të cilat ekzekutohen “pjesërisht” me urdhërat që ekzekutohen “plotësisht”.

4.3 Banka nuk do të ekzekutojë urdhërat e klientëve duke i bashkuar ato me urdhëra të klientëve të tjerë nëse nuk përmbushen kushtet e mëposhtme:

- a) Bashkimi i urdhërave të klientëve do të jetë në interesin më të mirë të klientëve të cileve u bashkohen urdhërat.
- b) Urdhërat limit apo urdhërat e tregut në lidhje me blerjen apo shitjen e instrumentave financiare kur këto urdhëra ndryshojnë në lidhje me një cmim të përcaktuar të instrumentit financiar të vendosur në urdhër.
- c) Urdhërat për blerje apo shitje instrumentash financiare të cilat janë vendosur në ditë të ndryshme, si dhe ato urdhëra të cilat kanë një periudhë të ndryshme validiteti.
- d) Urdhërat për blerjen apo shitjen e instrumentave financiare të klientëve të cilat diferencohen nga klientët në lidhje me vendin e ekzekutimit.

4.4 Urdhërat e bashkuar të klientëve duhet të shpërndahen/alokohen bazuar në faktorët si më poshtë:

- a) data dhe koha e vendosjes së urdhërit
- b) çmimi/njësi

- c) vlera totale e urdhërit
- d) ekzekutimi cilësor i parametrave të vendosur nga klienti
- e) çdo instruksion specifik i vendosur nga klienti

4.5 Shpërndarja e urdhërave të klientit duhet të bazohet në përputhje me parimin e "shpërndarjes së drejtë" sipas të cilës asnjë klient nuk mund të marrë më tepër ose më pak instrumenta financiare sesa sasia specifike e urdhëruar në lidhje me blerjen, dhe as më shumë dhe as më tepër para sesa sasia që rezulton si vlerë nga ekzekutimi i shitjes së urdhërit.

4.6 Në rastin e ekzekutimit të plotë të një urdhëri të bashkuar, shpërndarja e rezultatit do të jetë sipas parametrave të secilit urdhër klienti, dhe në përputhje me parimet e vendosura në këtë Procedurë. Në rastin e një ekzekutimi pjesor të urdhërit, i cili kombinon një ose më shumë urdhëra klientësh, shpërndarja e transaksioneve të lidhura do të jetë proporcionale me volumin e secilit urdhër, dhe në varësi të datës dhe kohës së pranimit të urdhërit, pa dëmtuar asnjë prej klientëve urdhërat e të cilëve janë bashkuar.

4.7 Nëse urdhëri i klientit ekzekutohet me një çmim më të favorshëm se çmimi që është përcaktuar nga klienti, i gjithë fitimi do ti përkasë klientit.

4.8 Nëse urdhëri i blerjes i bashkuar i klientit është ekzekutuar me çmime të ndryshme për pjesë të ndryshme të urdhërit total, shpërndarja e transaksioneve të lidhura dhe rezultatet e saj do të bazohen në kritere të tilla si: data, koha e vendosjes së urdhërit dhe volumi i secilit urdhër.

4.9 Në rast se Banka ka bashkuar një urdhër të klientit me një ose më tepër urdhëra të klientëve dhe urdhëri i bashkuar ekzekutohet pjesërisht, do të shpërndajë transaksionet që janë si rezultat i ekzekutimit të urdhërit duke përdorur metodologjinë "pro rata".

4.10 Në rast se Banka ka bashkuar urdhërat për transaksionet e një punonjësi të saj me një apo më tepër urdhëra klientësh, do të trajtojë në mënyrë të barabartë punonjësin e saj me klientët të cilët ka bashkuar urdhërat.

Neni 5.

Përzgjedhja e vendit të tregtimit

5.1 Urdhërat do të ekzekutohen nëpërmjet Brokerave/Dealerave me të cilët Banka ka marrëdhënie tregtimi. Banka do të përzgjedhë vendin e tregtimit duke marrë në konsideratë koston e transaksionit dhe sa më poshtë:

- Performancën e ekzekutimit bazuar në analizën Post Trade të ekzekutimeve me atë broker
- Aftësia për të gjetur likuiditet
- Cilësia e komunikimit dhe gadishmëria e brokerit për të kryer transaksione
- Analiza e Riskut të Brokerit

5.2 Personeli kyç i Bankës ka diskrecion në përzgjedhjen e çdo lloji vendi tregtimi nga lista e aprovuar e Brokerave që gjykon se do të përmbushë kërkesat e ekzekutimit më të mirë.

5.3 Vende të reja tregtimi mund të shtohen pas një procesi aprovimi. Ky proces aprovimi përfshin rishikimin e pasqyrave financiare të brokerit, reputacionin, si dhe analizën e AML.

5.4 Në lidhje me monitorimin e rrezikut të kundërpartisë, Banka do të monitorojë vlerën bruto të titujve të pashlyera.

5.5 Një listë me vendet e tregtimit në lidhje me çdo klasë të instrumentave financiare me të cilat Banka do të vendosë rëndësi të veçantë i bashkëlidhet kësaj politike/procedure. Banka rezervon të drejtën e ndryshimit të këtyre vendeve të tregtimit dhe rishikimit të listës.

Neni 6

Tregtimi në lidhje me aksionet

Banka do të ekzekutojë transaksione në aksione të cilat janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar duke tregtuar në një nga vendet e tregtimit të përcaktuar në Aneksin 1. Banka vendos urdhërin nëpërmjet Brokerave ndërkombëtare me të cilët ka marrëdhënie.

Vendet e tregtimit të përcaktuara në Aneksin 1 nuk janë shteruese, dhe ky aneks përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga Banka.

Neni 7

Udhëzimet specifike të klientit

Nëse Klienti i jep bankës një udhëzim specifik në lidhje me ekzekutimin e një urdhëri, Banka do të ndjekë këtë udhëzim për aq sa është e arsyeshme dhe e mundur kur ekzekuton urdhërin. Duke ndjekur udhëzimin specifik të klientit, Banka ka plotësuar kërkesën për të siguruar ekzekutimin më të mirë.

Nëse klienti i jep një udhëzim specifik që mbulon vetëm një pjesë të urdhërit ose një element të tij, Banka do të sigurojë ekzekutimin më të mirë për pjesën e pambuluar të urdhërit.

Klienti e njeh dhe bie dakord që dhënia e udhëzimeve specifike mund ta pengojë Bankën për të marrë të gjithë hapat e duhur për të implementuar detyrimin e saj për të siguruar Ekzekutimin më të mirë.

Neni 9

Tarifat dhe kostot

Banka nuk do të pranojë asnjë lloj tarife, komisioni apo pagesë shumash monetare nga palë të treta që lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e urdhërave të klientëve.

Përrjashtimisht nga sa më sipër Banka mund të pranojë përfitime jo monetare që lidhen me punë kërkimore të kryer nga brokerat me të cilët kryhet transaksioni.

Banka i njofton klientit listën e tarifave dhe komisioneve të bankës të cilat i shtohen tarifave dhe komisioneve të brokerit.

Neni 10

Rishikimi i Procedurës së Ekzekutimit më të mirë

Banka monitoron dhe rishikon rregullisht efektivitetin e kësaj procedure me cilësinë e ekzekutimit, dhe ku është e nevojshme korekton çdo lloj problematike.

Banka rishikon procedurën të paktën një herë në 3 vjet. Ky rishikim do të kryhet sa herë që ka një ndryshim material që ndikon Bankën për të përmbushur detyrimin e saj për të siguruar Ekzekutimin më të mirë.

Ndryshim material do të konsiderohet çdo ngjarje e rëndësishme që mund të ndikojë parametrat për të realizuar ekzekutimin më të mirë të tilla si kosto, çmimi, shpejtësia, probabiliteti i ekzekutimit dhe shlyerja, madhësia, natyra ose çdo lloj konsiderate tjetër relevante në lidhje me ekzekutimin e urdhërit.

Banka do të vlerësojë dhe do të analizojë vende të reja të tregtimit dhe brokera të tjerë rregullisht dhe do të përditësojë listën e përcaktuar në aneksin 1 menjëherë.

Aneksi 1

Vendet e Ekzekutimit të Urdhërave

Banka përdor vendet e ekzekutimit të renditura më poshtë kur kërkon të marrë ekzekutimin më të mirë në përputhje me këtë procedurë. Lista e mëposhtme nuk është shteruese dhe do të ndryshojë sa herë që Banka e konsideron të nevojshme për të siguruar që vendet e mëposhtme janë të përshtatshme për të mbuluar nevojat e biznesit dhe për të siguruar që janë marrë të gjithë hapat e mjaftueshëm për të arritur ekzekutimin më të mirë për klientët. Në veçanti, vende të tjera mund të shtohen herë pas here.

Lloji i Instrumentit	Vendet e Ekzekutimit
Tituj të Qeverisë Shqiptare (ekzekutim)	Bursa ALSE Tregu Nderbankar (Për shuma mbi 50 Milionë ALL) Ankandet e Titujve të Republikës së Shqipërisë
Aksione të tregtuara jashtë Republikës së Shqipërisë (marrje dhe transmetim urdhërash nepermjet Brokerave me të cilët vepron Banka, shih më poshtë)	Austria (Vienna Stock Exchange) Belgium (Euronext) Czech Republic (Prague Stock Exchange) France (Euronext) Germany (Deutsche Börse) Hungary (Budapest Stock Exchange) Italy (Borsa Italiana) Netherlands (Euronext) Norway (Oslo Bors) Poland (Warsaw Stock Exchange) Slovenia (Ljubljana Stock Exchange) Spain (Madrid Stock Exchange) Sweden (Nasdaq OMX) Switzerland (SIX Swiss Exchange) United Kingdom (London Stock Exchange) United States of America (NYSE, Nasdaq) United Kingdom (London Stock Exchange - IOB London – ADR, GDR):
Obligacione të tregtuara	Bloomberg, Reuters, nëpërmjet Brokerave me të cilët vepron Banka (shih më poshtë)

jashtë
Republikë
s së
Shqipërisë
(marrje
dhe
transmeti
m
urdhërash
)

Brokerat/Bankat me të cilët vepron Banka Amerikane e Investimeve

Për titujt e tregtuar jashtë Republikës së Shqipërisë

J.Morgan & Chase

Raiffeisen Bank International

Adamant Capital Partners

Banca Zarattini

Stonex

SFI Markets

Për titujt e tregtuar në Republikën e Shqipërisë

a) Në Bursën ALSE

Credins Bank

Intesa San Paolo Bank

b) Në tregun ndërbankar

Të gjitha Bankat e Licencuara nga Banka e Shqipërisë

